



E premte, 3 prill 2015

NJOFTIM PËR MEDIA

Në mbledhjen e datës 03.04.2015 Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka aprovuar Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) si dhe Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (KESCO).

Në bazë të vendimit për tarifën me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar të cilat do të aplikohen nga Furnizuesi Publik nga data 1 prill 2015 për vitin Rregullativ tarifor 2015 do të mbesin të njëjta. Ky Vendim do të jetë në fuqi deri më 31 mars 2016 për të gjithë konsumatorët e rregulluar.

Pas të gjitha analizave, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale prej 256.5 milion euro, në bazë të Vendimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik, i cili do t'i mbledh nga konsumatorët e rregulluar për të gjithë të Licencuarit. Bordi i ZRRE-së ka vendosur se tarifën e tanishme të rregulluar me pakicë, apo me saktësisht tarifën e vendosura për vitin rregullativ tarifor 2014 janë të mjaftueshme për funksionimin normal të sistemit elektro-energjetik të Kosovës.

Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në web faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka realizuar me të licencuarit gjatë periudhës dhjetor 2014 deri më 9 mars 2015. Këto dokumente janë:

- Vlerësimi përfundimtar i MAR të KEK-ut në kuadër të procesit të Shqyrtimit Periodik – Vlerësim i detajuar;
- Raport konsultativ - Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 9 mars 2015;
- Raporti Konsultativ - Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 9 mars 2015;
- Raporti Konsultativ - Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të KOSTT, i publikuar me datën 9 mars 2015;
- Raporti Konsultativ - Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të OSSH-së (KEDSS), i publikuar më datën 9 mars 2015;
- Raporti konsultativ - Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE), i publikuar më datën 9 mars 2015.
- Raportin “Përgjigjet ndaj komenteve-Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike” i cili është i publikuar me datën 03 prill 2015;
- Përcaktuesit e faturimit e Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE) për tarifa me pakicë për vitin Relevant tarifor 2015-2016, si dhe
- Aplikacionet e të gjithë të Licencuarve të cilat janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së <http://ero-ks.org/>

ZRRE sipas përgjegjësisë të saj do të vazhdojë të monitorojë të gjitha kostot e sistemit energjetik në Kosovë për të cilat do të informohet opinion publik.